



**UNIVERSITETI "KADRI ZEQA" UNIVERSITY**

Zija Shemsiu pn., 60000, Gjilan, Republika e Kosovës  
www.uni-gjilan.net tel: 0280390112

---

Ref. nr. \_\_\_\_\_ Dt. \_\_\_\_/\_\_\_\_/2020

---

Prof. Asoc. Dr. Bajram Kosumi  
Rektor

## **Fjalë në komemoracionin për Prof. Asoc. Dr. Arben Dërmaku**

Të nderuar të pranishëm,  
Sot na ka tubuar pikëllimi i thellë për vdekjen e hershme të kolegut tanë, një kohë edhe udhëheqësit tanë, Prof. Asoc. Dr. Arben Dërmaku.

Ju shprehë ngushëllimet e mia më të thella, në radhë të parë familjarëve të tij, pastaj kolegëve të punës, komunitetit të ekonomistëve të Kosovës dhe gjithë shokëve të tij.

Professor Arben Dërmaku ka qenë një prej ekonomistëve më të mirë të Kosovës, profesor në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Prishtinës. Është autor i disa librave nga fusha e ekonomisë, shumë punimeve shkencore dhe pjesëmarrës i shumë konferencave shkencore kombëtare e ndërkombëtare.

Ai ka qenë i përkushtuar në punën prej pedagogu. Mjafton të përmendim faktin se ai ka mentoruar disa qindra tema bachelor, mbi pesëdhjetë kandidatë në tema masteri dhe dy kandidatë në doktoratë. Për moshën e tij, ky është kontribut shumë i çmuar.

Ai ka qenë edhe nxitës i reformimit dhe modernizimit të arsimit të lartë në Kosovë dhe ka dhënë kontribut të çmuar në zhvillimin e jetës e të kulturës akademike. Në periudha të veçanta, ai e ka ndjerë përgjegjësinë publike dhe ka qartësuar opinionin publik, përmes shkrimeve të botuara në gazetata tona.

Por, për UKZ, profesor Arben Dërmaku njihet dhe mbahet në mendje në një përmasë tjetër: ai ka dhënë kontribut të madh në themelimin dhe në zhvillimin e hapave të parë të Universitetit “Kadri Zeka” në Gjilan.

Ka qenë kryetar i Këshillit për Themelimin e Universitetit Publik në Gjilan në vitin 2013, ushtrues detyre i Rektorit deri në vitin 2014 dhe anëtar i Këshillit Drejtues të këtij universiteti deri në vitin 2017.

Idetë e tija, punën e tij të palodhshme dhe vizionin për Universitetin tonë, edhe sot e sheh gjithandej universitetit. Vullneti i tij për ta ngritur Universitetin në rangun e universiteteve botërore do të jetë shembull që duhet ndjekur për të gjithë ne.

Profesor Arbeni ka qenë i përkushtuar edhe për familjen e tij. Secili që ka pasur shoqëri me të i di tregimet e tija të gjalla për djalin e tij Donin, të cilin e rritte me plot dashuri e pasion. Kjo dëshmon qasjen e tij humaniste ndaj jetës dhe shoqërisë.

Vdekja e hershme e ndau nga mesi ynë, por kontributi dhe rezultati i punës së tij do të vazhdojë të zhvillohet me ne.

Pusho në përjetësi i nderuari kolegu dhe miku ynë Arben!